Koha e lirë

Në kantonin Glarus ka mundësi të shumta atraktive për ta kaluar kohën e lirë. Një domethënje poaçërisht të madhe kanë shoqatat e shumta. Këto ofrojnë mundësi për të njohur njerzë të tjerë.

Shoqatat

Shumë banorë të kantonit Glarus janë anëtarë në ndonjë shoqate (Verein). Ka shoqata për interesa më të ndryshme të mundshme. Edhe në komuna të vogla ekzistojnë shoqata për sport, kulturë dhe shoqata të tjera. Ato ofrojnë mundësi ideale për të rënë në kontakt me njerëzit e tjerë. Shumica e shoqatave janë të hapura për të gjithë personat. Informatat në lidhje me shoqatat mund t'i gjeni edhe në webfaqet e komunave.

Ofertat për rininë (DE)

Për të rinjët në kantonin Glarus ka shumë oferta specifike për ta kaluar kohën e lirë dhe për të njohur bashkëmoshatarë. Në shumë komuna ka pikëtakime dhe oferta të ndryshme për ta kaluar kohën e lirë. Të rinjët janë aty nën përkujdesje. Ata munden ti sjellin idetë e tyre dhe me t'i realizue projektet e tyre (Jugendarbeit). Sipas rregullit ofertat janë falas. Shoqatat e të rinjëve ofrojnë mundësi për të ndërmarrë aktivitete sëbashku me bashkëmoshatarë dhe për t'u marrë me sport në natyrë. Bartës të ofertave janë shoqatat, Komunat apo kishat e vendit. Ofertat janë të hapura për të gjithë të rinjët. Në Komunën ku jetoni mund të merrni informata të tjera.

Shëtitjet dhe kultura

Kantoni Glarus ofron mundësi të shumta për shëtitje (ekskurzione) dhe ofertë të pasur kulturore. Liqenet e famshme malore dhe specialitetet e Glarus-it janë të shumta. Kush gjendet në rrugtim e sipër në Kantonin Glarus do të shoqërohet nga një panoramë malore e mrekullueshme. Përveç kësaj ka edhe shumë stigje të bukura shtetgtimi dhe për biçikleta. Destinacionet më të preferuara të ekskursionit janë Elm dhe Braunwald. Të dyja zonat ofrojnë mundësi të shkëlqyera për stegtim, shëtitje dhe për sporte dimërore. Muzetë e shumta ofrojnë ekspozita me tema të ndryshme. Freulerpalast (Pallati i Freuler) në Näfels ofron njohuri të përgjithshme për historinë e Kantonit Glarus. Poashtu edhe Muzeu Anna Göldi në Ennenda ofron gjithashtu përshtypje interesante për historinë e Anna Göldi dhe tema të tjera. Në të gjithë Zvicrën është e njohur shtëpia e artit (Kunsthaus) e Glarus-it. "Glarnerland Tourismus" ofron informacion për ekskursionet e mundshme dhe manifestimet. Informatat për manifestimet aktule kulturore mund të gjenden gjithashtu në gazetat lokale dhe "Glarner Agenda".

Puna vullnetare

Puna vullnetare (Feiwilligenarbeit) është një kontribut shoqëror për njerëzit dhe ambientin e cila nuk paguhet. Në Zvicër tradicionalisht një numër i madh obligimeve kryhet nga vullnetarët. Një pjesë e madhe e punëve kryhen në shoqata. Kështu mund të angazhoheni në shoqatat për kulturë, sport, qështje sociale, arsim, për mbrojtjen e kafshëve dhe ambientit, shëndetësi dhe në fusha të tjera. Informatat për punën vullnetare dhe mundësitë e angazhimit mund ti merrni pranë zyrës së specializuar për punë vullnetare "Benevol". Angazhimet vullnetare në fushën e migrimit, azilit dhe refugjatëve, në shumicën e rajoneve të Kantonit, i ndërmjetëson Zyra Koordinuese për Punë Vullnetare FRAMI.

Sporti / Kultura / Arsimimi

Përkundër madhësisë së tij modeste Kantoni Glarus është një parajsë për sportin, kulturën dhe arsimin: Kushdo që dëshiron të merret me sport sëbashku me të tjerët, në kapitullin "oferta për rini" (Angebote für Jugendliche), mund t'i gjejë linqet për shoqatat e sportit. Kushdo që dëshiron të lëvizë në mënyrë të pavarur, ai në Glarus ka në dispozicion mundësi të panumërta si brenda ashtu edhe jashtë. Oferta varion nga qendra e fitnesi te Yoga, Pilates, Parcour deri te shtigjet e biçikletave, duke i përmendur vetëm disa nga ato. Brenda pak minutash mund të arrini gjithçka që ua dëshirin zemra, nga sportet ujore në liqen deri tek alpinizmi në akullnaja. Ofertat kulturore janë jashtëzakonisht të larmishme (www.glarneragenda.ch).
Me kartën - Kulturlegi, nerëzit me pak para përfitojnë ulje në aktivitete sportive, kulturore dhe edukative. Kjo kartë mund të kërkohet në Caritas. Caritasi informon lidhur me këtë dhe verifikon nëse keni të drejtë të keni Kulturlegi.
Sa i përket arsimit, përpos fakulteteve, në Kanton mund të vijohen të gjitha mësimet tjera.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-glarus.ch/sq/kantoni-glarus/koha-e-lire